



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr. 69**

**21 qershor**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 372, datë 12.6.2012	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Potam” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë....	3287
Vendim i KM nr. 373, datë 16.5.2012	Për kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën dhe lirimimin nga detyra të kryeinspektorit të Inspektoratit Shtetëror.....	3287
Vendim i KM nr. 375, datë 6.6.2012	Për krijimin, regjistrimin, mënyrën e funksionimit, të administrimit e të ndërveprimit dhe për sigurinë e sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ALBSReP).....	3291
Vendim i KM nr. 376, datë 6.6.2012	Për procedurën e lëshimit të dokumenteve nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.....	3297
Vendim i KM nr. 377, datë 6.6.2012	Për kriteret që duhet të plotësojë organi që realizon mbikëqyrjen elektronike, rregullat për përzgjedhjen dhe të drejtat e detyrimit e tij.....	3298
Vendim i KM nr. 378, datë 6.6.2012	Për dhënie ndihme financiare Qeverisë së Republikës së Italisë, për lehtësimin e pasojave të shkaktuara nga tërmeti në veri të Italisë.....	3303
Vendim i KM nr. 379, datë 6.6.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Brendshme, për dhënie ndihme financiare familjeve të viktimave dhe të mbijetuarve të aksidentit rrugor, të datës 21.5.2012, në aksin Vlorë-Sarandë, në vendin e quajtur Vishë të Himarës.....	3303

Kërkesë e MPPT nr. 2758, datë 13.6.2012	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga masterplani, miratuar me vendimin nr. 546, datë 28.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e masterplanit për zhvillimin e Portit të Durrësit”.....	3305
	Vendim për shpalljen të zhdukur të shtetasit Elvis Ahmetli.....	3306
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Prendi Bobo.....	3306
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasës Brunilda Alla.....	3306
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Josif Karaj.....	3306

**VENDIM**  
**Nr. 372, datë 12.6.2012**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME  
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “POTAM” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË  
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autoriteti kontraktues, për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Potam” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2% të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), për dhënie me koncesion të këtij hidrocentrali, që i jepet shoqërisë “2 FAF” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Potam”, të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr. 373, datë 16.5.2012**

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR PËRZGJEDHJEN, EMËRIMIN, VLERËSIMIN  
E REZULTATEVE NË PUNË, DISIPLINËN DHE LIRIMIN NGA DETYRA TË  
KRYEINSPEKTORIT TË INSPEKTORATIT SHTETËROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**FUSHA E ZBATIMIT**

Kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën dhe lirimin nga detyra të kryeinspektorit, sipas këtij vendimi, do të zbatohen edhe për titullarin e organit të varësisë në kuptim të pikës 2 të nenit 10 të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.



## KREU II EMËRIMI I KRYEINSPEKTORIT

1. Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror, më poshtë “kryeinspektori”, emërohet nga Kryeministri, me propozim të ministrit përkatës, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Ministri përkatës urdhëron, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së emërimit, shpalljen në media të vendit të lirë.

3. Kandidatët e paraqitur, krahas kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, sipas nenit 12 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, duhet të plotësojnë njëkohësisht këto kërkesa të posaçme:

a) Të kenë arsim të lartë në drejtësi, ekonomi, menaxhim, administrim publik ose në fushën profesionale, ku gjen zbatim ligji i posaçëm;

b) Të kenë përvojë pune në administratën shtetërore, të paktën 5 (pesë) vjet, nga të cilat të paktën 3 (tri) vjet në nivele drejtuese.

4. Për shqyrtimin e kandidaturave, ministri krijon një komision *ad hoc*, që ka në përbërje të tij 3 nëpunës të nivelit të lartë drejtues të ministrisë përkatëse. Komisioni shqyrton plotësimin e kriterëve të parashikuara në pikën 3 të këtij vendimi dhe vlerëson kandidatët e klasifikuar në bazë të treguesve të mëposhtëm:

a) Rezultateve të studimeve universitare apo pasuniversitare;

b) Përvojave të mëparshme në punë që lidhen me pozicionin;

c) Vlerësimeve të punës;

ç) Trajnimeve apo specializimeve të ndryshme;

d) Të dhënave për studimet e kryera apo botimet në fusha që i shërbejnë pozicionit;

dh) Të dhënave për integritetin moral;

e) Të dhënave për masa disiplinore;

ë) Të dhënave për aftësi të spikatura organizative dhe menaxhuese;

f) Çdo të dhënë tjetër që tregon përparësi të kandidatit përkatës ndaj kandidatëve të tjerë.

5. Në shqyrtimin e kandidaturave për vendin vakant të kryeinspektorit, ministri përkatës merr në konsideratë edhe rekomandime të shkruara nga persona publikë të shquar, veçanërisht në fusha që i shërbejnë pozicionit të punës.

6. Gjatë shqyrtimit të kandidaturave që do të propozohen për emërim në pozicionin e kryeinspektorit, ministri mund të ketë një komunikim të drejtpërdrejtë me to.

7. Ministri përkatës i propozon Kryeministrit jo më pak se 3 (tri) nga kandidaturat e paraqitura, që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 4 të këtij kreu, emërimi i të cilave nuk çon në një gjendje të pazgjidhshme konflikti interesi sipas legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

8. Kryeministri emëron njërin prej kandidaturave të paraqitura.

## KREU III VLERËSIMI I ARRITJEVE INDIVIDUALE TË KRYEINSPEKTORIT

1. Periudha e vlerësimit të rezultateve individuale në punë për kryeinspektorin është një vit kalendarik dhe fillon nga data 1 nëntor deri në 31 tetor, të vitit pasardhës. Ministri përkatës kryen vlerësimin profesional të tij.

2. Vlerësimi profesional do të bazohet në arritjen e objektivave vjetorë dhe afatmesëm strategjikë të Inspektoratit Shtetëror për çdo kryeinspektor dhe në aftësitë kryesore që nevojiten për të kryer detyrat, si më poshtë vijon:

a) Shkalla/niveli i realizimit të objektivave të përcaktuar për t'u përmbushur gjatë ushtrimit të aktivitetit të inspektoratit dhe për hartimin e zbatimin e strategjisë së institucionit;

b) Mbarëvajtja e punës së inspektoratit në përgjithësi, ku përfshihen menaxhimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore e menaxhimi e miradministrimi i mjeteve financiare të inspektoratit, si dhe zhvillimi i infrastrukturës së institucionit;

c) Efektiviteti dhe cilësia e kryerjes së inspektimeve e raportimeve, nismat e ndërmarra, pjesëmarrja dhe përkushtimi në punë, organizimi i punës, risitë e arritura apo të identifikuara gjatë procesit të punës e zbatimit të programit të inspektimit; hartimi i metodologjive përkatëse të programimit, si dhe komunikimi cilësor me komunitetin e biznesit që mbulon inspektorati i tij dhe me publikun;

ç) Zbatimi i detyrave dhe i përgjegjësive përkatëse me profesionalizëm dhe rigorozitet, si dhe në përputhje me dispozitat ligjore;

d) Bashkëpunimi me autoritet, qendrore dhe vendore, ministrin përgjegjës, Inspektoratin Qendror e inspektoratet e tjera apo autoritetet homologe brenda dhe jashtë vendit, në funksion të përmbushjes së dispozitave ligjore për inspektimin dhe dispozitave të tjera lidhur me to, në fushën përkatëse;

dh) Respektimi dhe zbatimi i detyrave dhe i përgjegjësive përkatëse me efikasitet, bazuar në parimet e mira të kryerjes së punës, si ruajtja e sekretit shtetëror dhe sekretit profesional, ruajtja e konfidencialitetit, zbatimi i parimeve dhe dispozitave ligjore në fuqi për konfliktin e interesave;

e) Kriteria të tjera që ministri përgjegjës i konsideron të arsyeshme dhe të përshtatshme për t'u vlerësuar.

3. Vlerësimi i përgjithshëm do të bëhet në katër nivele të mbarëvajtjes në punë, që janë: Shumë mirë, mirë, mjaftueshëm dhe jomjaftueshëm, ku tri të parat do të konsiderohen vlerësime pozitive dhe i katërti negativ.

#### KREU IV MASAT DHE PROCEDIMI DISIPLINOR

1. Ndaj kryeinspektorit mund të procedohet me masë disiplinore për shkelje të ligjit dhe të normave të etikës që konsiderohen shkelje të disiplinës në punë.

2. Shkeljet e disiplinës në punë ndahen në:

a) shkelje të lehta;

b) shkelje të rënda;

c) shkelje shumë të rënda.

3. Konsiderohen shkelje disiplinore shumë të rënda:

a) mosrespektimi me dashje dhe në mënyrë të përsëritur i disiplinës formale në punë, kur ka sjellë pasoja negative në veprimtarinë e përditshme të Inspektoratit;

b) mosparaqitja e pajustificuar në detyrë për mbi 7 (shtatë) ditë;

c) refuzimi i përsëritur dhe i papërligjur i përmbushjes së urdhrave dhe detyrave të ligjshme;

ç) mungesa në vazhdimësi e përkushtimit dhe motivimit në përmbushjen e rregullt të detyrës;

d) kryerja me dashje dhe në vazhdimësi e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës;

dh) kryerja e akteve apo sjelljeve ose manifestimi i mungesës së etikës, që diskreditojnë rëndë figurën e kryeinspektorit apo dhe të Inspektoratit Shtetëror përkatës.

4. Konsiderohen shkelje disiplinore të rënda:

a) mosrespektimi në mënyrë të përsëritur i disiplinës formale në punë, kur ka sjellë krijimin e situatave të papërshtatshme apo të pajustificuara;

b) mosparaqitja e pajustificuar në detyrë për mbi 7 (shtatë) ditë radhazi;



c) refuzimi i pajustificuar i përmbushjes së urdhrave dhe detyrave të ligjshme;  
ç) mungesa e përkushtimit dhe e motivimit në përmbushjen e rregullt të detyrës;  
d) kryerja e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës;  
dh) kryerja e akteve apo sjelljeve ose manifestimi i mungesës së etikës, të një rëndësie më të ulët se ato të parashikuara në pikën 3 shkronja “dh” të këtij kreu, që diskreditojnë rëndë figurën e kryeinspektorit apo dhe të Inspektoratit Shtetëror përkatës.

5. Konsiderohet shkelje disiplinore e lehtë çdo lloj shkeljeje që nuk kategorizohet si shumë e rëndë apo e rëndë.

6. Nismën për fillimin e një procesi verifikimi e ndërmerr ministri përkatës dhe Inspektori i Përgjithshëm, proces i cili realizohet nga një komision *ad hoc*, i ngritur me urdhër të ministrit. Komisioni *ad hoc* ka në përbërje të tij 3 (tre) nëpunës të nivelit të lartë drejtues të ministrisë përkatëse.

7. Kur ministri vendos fillimin e procedurës disiplinore, njofton menjëherë, me shkrim, kryeinspektorin:

a) për të drejtën që ai ka për të paraqitur me shkrim sqarimet e tij rreth shkeljes së pretenduar dhe për afatin deri kur duhet të paraqitet ky sqarim. Ky afat nuk mund të jetë më i shkurtër se 8 (tetë) ditë nga data e marrjes së njoftimit;

b) për të drejtën që ai ka për t’u dëgjuar, vetë apo me përfaqësues ligjor dhe për të paraqitur dëshmitarë;

c) për të drejtën që ai ka për të paraqitur para ministrit ose komisionit *ad hoc* prova që ai i vlerëson të nevojshme për të provuar pretendimet e tij, të cilat i nënshtrohen shqyrtimit, duke mos pasur asnjëra prej tyre vlerë të paracaktuar;

ç) për datën kur do të shqyrtohet shkelja e pretenduar. Ky afat nuk mund të jetë më i shkurtër se 8 (tetë) ditë nga data e marrjes së njoftimit.

8. Procedimi disiplinor mund të fillohet brenda 3 (tre) muajve nga data e konstatimit të shkeljes, por jo më vonë se 2 (dy) vjet nga data e kryerjes së saj.

9. Ministri përkatës nis procedimin disiplinor dhe vendos për masën disiplinore në bazë të llojit dhe karakterit të shkeljes së kryer.

10. Komisioni *ad hoc*, pasi shqyrton çështjen sipas rregullave të përcaktuara në pikat 6 e 7 të këtij kreu, dhe pasi dëgjon kryeinspektorin a përfaqësuesin ligjor apo pasi vë në dukje, me shkrim, mosparaqitjen e tij megjithëse ai ka marrë dijeni kundrejt konfirmimit, ia dërgon raportin e hartuar ministrit, i cili vendos:

a) marrjen e një mase disiplinore apo propozimin e saj në rastin e shkronjës “c” të pikës 11 të këtij kreu, kur vëren se ka pasur shkelje disiplinore;

b) ndërprerjen e ecures disiplinore, në rastet kur vëren se:

- nuk ka shkelje disiplinore, siç ishte menduar;

- veprimi i shqyrtuar nuk përbën shkelje;

- veprimi nuk ka qenë ose nuk është kryer nga kryeinspektori.

11. Masat disiplinore janë:

a) Vërejtje me shkrim;

b) Vërejtje me paralajmërim;

c) Shkarkim nga detyra.

12. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore. Nuk është e nevojshme të merren të gjitha masat disiplinore para se kryeinspektori të shkarkohet nga detyra.

13. Masa disiplinore parashkruhet me kalimin e 2 (dy) viteve nga dhënia e saj.

14. Propozimi për shkarkimin nga detyra të kryeinspektorit vendoset vetëm për shkelje disiplinore shumë të rënda ose kur është ndëshkuar më parë me masë disiplinore për shkelje të rënda.

15. Kryeministri urdhëron shkarkimin e kryeinspektorit kryesisht ose me propozim të ministrit përkatës.

**KREU V  
LIRIMI NGA DETYRA**

1. Lirimi nga detyra i kryeinspektorit bëhet kur:
  - a) konstatohet se nuk i plotëson më kriteret e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil;
  - b) ka mbushur moshën për të dalë në pension;
  - c) merr dy vlerësime negative të njëpasnjëshme të punës për arritjen e objektivave vjetorë dhe afatmesëm strategjikë të Inspektoratit Shtetëror;
  - d) jep dorëheqjen.
2. Lirimi nga detyra i kryeinspektorit bëhet me urdhër të Kryeministrit, kryesisht ose me propozimin e ministrit përkatës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Sali Berisha**

**VENDIM  
Nr. 375, datë 6.6.2012**

**PËR KRIJIMIN, REGJISTRIMIN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT, TË ADMINISTRIMIT E TË NDËRVEPRIMIT DHE PËR SIGURINË E SISTEMIT TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (ALBSReP)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr. 10 325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” dhe të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Objekti i këtij vendimi është krijimi i bazës së të dhënave shtetërore “Sistemi i Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ALBSReP)”.
  2. ALBSReP-ja përmban:
    - a) të dhënat për pasuritë e paluajtshme dhe faktet që kanë lidhje me gjendjen juridike të tyre, bazuar në të gjithë informacionin e dokumentacionit tekniko-ligjor, kartelave dhe hartave treguese të regjistrimit/hartave kadastrale, të krijuara në format elektronik, për pasuritë e paluajtshme që i janë nënshtuar regjistrimit fillestar;
    - b) dokumentet e punës;
    - c) dokumentet ku evidentohet mënyra e ndërveprimit me institucionet e tjera;
    - ç) elementet e sigurisë;
    - d) informacionin për proceset e punës;
    - dh) materialet për instruktim, në ndihmë për përdoruesin e sistemit;
    - e) ndërfaqe të bazuar në teknologjinë portal;
    - ë) funksionet e kërkimit;
    - f) raportet statistikore për administrimin e kërkesave dhe elementeve të tjera të lidhura me to, llojin e pasurive të paluajtshme dhe elementeve të tjera të lidhura me to, llojin e pronarëve dhe elementeve të tjera të lidhura me ta.



3. Përbërësit e arkitekturës “software” dhe “hardware” të sistemit parashikohen në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Të dhënat që përmban ALBSReP-ja ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e mbledhura në kohë reale nga ALBSReP-ja dhe që kanë të bëjnë me:

i) dokumentacionin tekniko-ligjor të pasurisë së paluajtshme. Dokumentet tekniko-ligjore i kthehen subjektit përkatës, pas ruajtjes së imazhit të tyre.

ii) kartelat e pasurive të paluajtshme;

iii) hartat treguese/hartat kadastrale të pasurive të paluajtshme;

iv) dokumente të punës, ku përfshihen aktet që krijon kryeregjistruesi/regjistruesi, përgjatë veprimtarisë së tij.

b) Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat e siguruar nga ndërveprimi me baza të tjera të të dhënave shtetërore dhe kanë të bëjnë me:

i) palët;

ii) të tretët;

iii) të dhënat e titujve të pronësisë;

iv) ndërveprimin me institucionet e tjera.

5. Modeli i paraqitjes së të dhënave parësore dhe atyre dytësore parashikohet në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Subjektet përgjegjëse të ALBSReP-së janë:

a) Institucioni administrues është Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

b) Dhënës të informacionit janë:

i) Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;

ii) zyrat vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

c) Subjekte të interesuara janë:

i) pronari i pasurisë së paluajtshme;

ii) noterët publikë;

iii) çdo subjekt tjetër, i përcaktuar shprehimisht me vendim të Këshillit të Ministrave.

ç) Niveli i aksesit në ALBSReP është:

i) për noterët publikë, e drejta e leximit dhe e printimit të informacionit mbi dokumentet në formën shifrore që tregojnë gjendjen juridike të pasurisë së paluajtshme, pasi të kenë marrë pëlqimin e palës së interesuar, sipas përcaktimeve të nenit 54 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar;

ii) për subjektet e tjera, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave, që u jepet e drejta e aksesit për verifikim në këtë sistem.

7. Ndërveprimi i ALBSReP-së me bazat e të dhënave:

- ALBSReP-ja i merr të dhënat dytësore nga bazat e të dhënave shtetërore, ku ato ekzistojnë si të dhëna parësore.

- Të dhënat që shkëmbehen me bazat e tjera të të dhënave shtetërore përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë me drejtuesit e institucioneve që administrojnë bazat e të dhënave shtetërore, duke u koordinuar me Autoritetin Rregullator Koordinues të bazave të të dhënave shtetërore.

8. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



## ANEKSI 1

### KOMPONENTËT E ARKITEKTURËS *SOFTWARE* DHE *HARDWARE* TË ALBSReP-së PËRSHKRIM TEKNIK I ALBSReP-së

Arkitektura teknike dhe funksionale e “Sistemit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” është e orientuar për realizim të shpejtë, të saktë dhe me cilësi të shërbimeve ndaj klientit dhe me kosto minimale. Arkitektura e Sistemit mundëson menaxhimin me sukses të veprimeve të lidhura me pasurinë e paluajtshme, dokumenteve dhe proceseve të punës në përputhje me legjislacionin shqiptar, rregullave e rregulloreve të ZRPP-së.

#### ARKITEKTURA FUNKSIONALE

Arkitektura funksionale e sistemit është dizenuar e tillë që të plotësojë maksimalisht të gjitha shërbimet e kërkuara nga ZRPP-ja, si nga ana e proceseve të punës, ashtu dhe nga ajo organizative. Për sa i përket anës operative, ajo u siguron operatorëve të ZRPP-së, dhe klientëve të saj shtetërorë apo privatë, një sistem fleksibël me një shkallë të lartë automatizimi, duke pasur efikasitet maksimal. Efikasiteti i lartë do të sigurojë rritjen e cilësisë së shërbimit të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme ndaj qytetarëve dhe institucioneve shtetërore e private. Për sa i përket anës organizative, arkitektura funksionale nëpërmjet raporteve dhe statistikave u jep mundësinë organeve përkatëse të kenë në kohë reale dhe në mënyrë të saktë të gjithë informacionin e duhur për të kontrolluar dhe përmirësuar strukturën dhe funksionimin e këtij shërbimi.

Elementet themelore të arkitekturës funksionale janë: dokumentet tekniko-ligjore të lidhura me pasurinë e paluajtshme, përgatitja e kartelës së pasurisë së paluajtshme për pronën e gjithsecilit dhe dokumentimi i kufijve të kësaj pasurie të paluajtshme në Hartën Treguese të Regjistrimit/Hartën Kadastrale.

Këto elemente janë të ndërlidhura midis tyre dhe çdo element apo objekt tjetër në sistem është i lidhur me to:

- Veprimet me pasuritë e paluajtshme
- Dokumentet, palët, fazat
- Kontakte kontrollet, raportet etj.

Sistemi i Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, i ndërtuar në bazë të kërkesave të ZRPP-së, përbën një sistem të plotë dhe të avancuar, duke plotësuar tërësisht kërkesat e shkallëzuara dhe të sofistikuar të shërbimit të ZRPP-së. Karakteristikat ose funksionet e tij kryesore mund të përmbliken si më poshtë:

#### REGJISTRIMI I PASURISË SË PALUAJTSHME

- Regjistrimi i pasurisë së paluajtshme në formë shifrore;
- Përpunimi i informacionit shifror sipas shërbimeve të kërkuara;
- Ruajtja dhe përditësimi i informacionit shifror;
- Monitorimi për pasaktësi informacioni apo shërbimesh dhe ndjekja e tyre deri në zgjidhje;
- Raporte statistikore për çështje të vonuara, të pasakta, apo të pazgjidhura.

#### MENAXHIMI I DOKUMENTEVE

- Regjistrimi i dokumenteve në formë shifrore;
- Ruajtja dhe përditësimi i dokumenteve shifrore;
- Prodhimi i dokumenteve të reja, lidhur me shërbimet e ofruara;
- Kategorizimi i dokumenteve.



#### MENAXHIMI I KËRKESAVE

- Regjistrimi elektronik i kërkesave dhe lidhja e tyre me pasurinë e paluajtshme përkatëse;
- Ndjekja e realizimit në kohë të kërkesave;
- Raporte për kërkesa të vonuara;
- Ruajtja e historikut të veprimeve të kryera mbi pasurinë e paluajtshme, në bazë të kërkesave përkatëse.

#### SIGURIA

- Siguri në nivel objekti apo dokumenti;
- Klasifikimi i sigurisë.

#### RRJEDHA PUNE TË STRUKTURUARA DHE TË VEÇANTA

- Automatizimi i proceseve;
- Futja e elementeve të reja, sipas kërkesave të biznesit apo të shërbimit ndaj klientëve;
- Rishikimi i cikleve të kërkesave të bëra;
- Menaxhimi i rregullave.

#### TRAJNIMI DHE NDIHMA

- Ndhmë dhe trajnim i vazhdueshëm i përdoruesit;
- Ndhmë në përputhje me përmbajtjen.

#### NDËRFAQE E BAZUAR NË TEKNOLOGJINË PORTAL

- *webservice*;
- Ndërfaqe e bazuar sipas roleve.

#### NAVIGIM/KËRKIM

##### RAPORTIM

- Të dhëna, analiza dhe statistika në kohë reale të lidhura me pronat apo shërbimet mbi pasuritë e paluajtshme

#### ARKITEKTURA TEKNIKE

Arkitektura teknike e sistemit është në përputhje me kërkesat teknike dhe e bazuar në teknologjitë bashkëkohore *hardware* dhe *software*, teknologji që sigurojnë menaxhim dhe kontroll të plotë të proceseve të punës dhe dokumenteve të sistemit të regjistrimit.

#### ARKITEKTURA *SOFTWARE*

Arkitektura *software* e sistemit është në përputhje me kërkesat teknike dhe e bazuar në platformën RDBMS, e cila në bashkëpunim me komponentët e tjerë mundëson menaxhimin e kërkesave mbi pasuritë e paluajtshme dhe dokumentet në mënyrë të pajtueshme me të gjitha llojet e rregullave institucionale apo ligjore të ZRPP-së.

Gjithashtu, ajo bën të mundur kontrollin dhe menaxhimin e të gjitha proceseve, informacionit dhe sigurisë lidhur me pasuritë e paluajtshme.

Komponentët *software* të përdorura vijnë si më poshtë:

1. *Microsoft Windows Server*: sistemi operativ (Operating System);
2. Baza e të dhënave RDBMS;
3. *Web Application Server*;
4. RDBMS *Server*.

#### HIERARKIA E PËRDORUESVE

Sistemi do të ketë këto role përdoruesish:

- Administratori i sistemit: do të ketë të drejtat e administrimit të sistemit;
- Administratori i rrjetit: do të ketë të drejtat e administrimit të rrjetit;
- Operatorët: janë përdorues të ZRPP-së;
- Klientët: do të ofrohet shërbimi *on-line*.

#### ARKITEKTURA *HARDWARE*

Arkitektura teknike *hardware* është një arkitekturë e dizenuar, duke përdorur pajisje të teknologjisë bashkëkohore, që bëjnë të mundur funksionimin me performancë maksimale të sistemit.

Pajisjet e njësisë qendrore përfshijnë infrastrukturën e mëposhtme:

1. RDBMS Server;
2. WEB Application Server;
3. Firewall;
4. UPS të instaluar në një Rack ;
5. Gis Server, Back up server, Pajisjet e rrjetit dhe komunikimit, Directory Server, Web Server, Portal Server.

#### ANEKSI 2

#### MODELI I PARAQITJES SË TË DHËNAVE TË SISTEMIT

##### 1. Të dhëna parësore

Sistemi i Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ALBSReP) regjistron këto të dhëna parësore:

Kërkesa ka këto të dhëna:

- Numër i kërkesës;
- Datë e kërkesës;
- Zyra Vendore ku bëhet kërkesa;
- Zona kadastrale;
- Pasuritë e paluajtshme të përfshira në kërkesë;
- Kërkuesi;
- Përfaqësuesi;
- Adresa e kthimit të përgjigjes;
- Shërbimet që kërkohen në kërkesë;
- Taksat dhe tarifatat për çdo shërbim;
- Pagesa totale për shërbimin;
- Taksa e kalimit të pronësisë, në rastin kur shërbimi i kërkuar është kalim pronësie;
- Dokumentet e nevojshme për secilin shërbim;
- Elemente identifikuese (numër, datë, numër faqesh) për secilin dokument.

Kartela ka këto të dhëna:

- Seksioni A – Seksioni i identifikimit të pasurisë së paluajtshme
- Zona kadastrale;
- Indeksi i hartës;
- Numri i pasurisë së paluajtshme;
- Adresa e pasurisë së paluajtshme;
- Statusi i pasurisë së paluajtshme.
- Seksioni B – seksioni i përshkrimit të pasurisë së paluajtshme
- Brenda apo jashtë vijës kufizuese ndarëse VKN (urbane - rurale);
- Dokumenti vërtetues brenda VKN;
- Lloji i pasurisë së paluajtshme;



- Sipërfaqja totale;
  - Sipërfaqja truall;
  - Sipërfaqja ndërtim;
  - Përshkrim i veçantë i pasurisë së paluajtshme;
  - Numri i pasurisë së paluajtshme pallat;
  - Pjesëmarrja në pasurinë e paluajtshme e përbashkët pallat.
  - Seksioni C – Seksioni i pasurisë së paluajtshme
  - Referenca e transaksionit;
  - Data e transaksionit;
  - Emër pronari;
  - Atësi pronari;
  - Mbiemër pronari;
  - Dokumenti i identifikimit – lloji (pasaportë, kartë identiteti);
  - Numri i dokumentit të identifikimit;
  - Adresa e pronarit;
  - Data e lëshimit të certifikatës;
  - PAGESA për transaksionin (për fitimin e pronësisë);
  - Shënime.
  - Seksioni D – Seksioni i qirave, në përdorim, marrëveshjeve kufizuese, servituteve dhe marrëveshjeve të tjera
  - Referenca e transaksionit;
  - Data e transaksionit;
  - Përshkrimi i transaksionit;
  - Data e lëshimit të certifikatës;
  - Afati i vlefshmërisë së transaksionit;
  - Shënime.
  - Seksioni E – Seksioni i hipotekave, vendimeve të gjykatës, kufizimeve etj.
  - Referenca e transaksionit;
  - Data e transaksionit;
  - Përshkrimi i transaksionit;
  - Data e lëshimit të certifikatës;
  - Afati i vlefshmërisë së transaksionit;
  - Shënime.
- Harta treguese të regjistrimit/harta kadastrale ka këto fusha:
- Numri i pasurisë së paluajtshme;
  - Numri kombëtar identifikues i poligonit të pasurisë së paluajtshme;
  - Poligoni i pasurisë së paluajtshme;
  - Sipërfaqja ligjore;
  - Pika e referimit.
- Dokumentacioni tekniko-ligjor ka këto fusha:
- Kodi i dokumentit;
  - Emërtimi i dokumentit;
  - Numri;
  - Data;
  - Burimi;
  - Numër faqesh;
  - Origjinal ose jo;
  - Dokumenti i skanuar.

**VENDIM**  
**Nr. 376, datë 6.6.2012**

**PËR PROCEDURËN E LËSHIMIT TË DOKUMENTEVE NGA ZYRAT E REGJISTRIMIT  
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 70 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe të paragrafit të fundit të nenit 23 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kërkesa për kryerjen e një shërbimi nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në zbatim të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, bëhet nga kërkuesi, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, noteri apo asistenti i noterit.

2. Në formularin e kërkesës, subjektet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, shënojnë qartë emrin, mbiemrin, adresën e saktë dhe/ose orientimin faktik të vendndodhjes, numrin e telefonit dhe/ose numrin e telefonit celular, si dhe adresën e postës elektronike.

3. Pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme funksionon regjistri elektronik i përpunimit të kërkesave, me të cilin operojnë punonjësit e zyrës nën përgjegjësinë e regjistruarit. Pa cenuar garantimin e procesit të trajtimit të kërkesave, në përputhje me kronologjinë e paraqitjes së tyre, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme përcaktojnë një numër punonjësish për të trajtuar kërkesat që paraqiten nga noterët apo asistentët e tyre.

4. Regjistri elektronik i përpunimit të kërkesave garanton trajtimin e praktikave sipas radhës së paraqitjes së kërkesave.

5. Kryeregjistruari miraton, me udhëzim, procedurat standarde të veprimeve me regjistrin elektronik të përpunimit të kërkesave, përfshirë përshkrimin e veprimeve të kryera nga zyra, që pasqyrohen në këtë regjistër. Minimalisht, në regjistër regjistrohen numri i kërkesës, data e paraqitjes dhe data e përfundimit të afatit për trajtim, sipas rendit kronologjik.

6. Regjistri elektronik kontrollohet çdo ditë nga regjistruari, i cili është përgjegjës për trajtimin e kërkesave.

7. Regjistruari, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, përveç rasteve kur në ligj përcaktohet një afat tjetër, është i detyruar të plotësojë kërkesën e paraqitur, në përputhje me legjislacionin në fuqi ose, në rast të kundërt, të kthejë përgjigje, me shkrim, për shkaqet ligjore që e detyrojnë atë të mos miratojë kërkesën apo të kërkojë një kohë më të gjatë nga ajo e përcaktuar më sipër.

8. Kryeregjistruari, jo më pak se një herë në dy muaj, verifikon ligjshmërinë e të gjitha rasteve, kur është kaluar afati i përcaktuar në pikën 7 të këtij vendimi dhe i paraqet një raport të hollësishëm Ministrit të Drejtësisë dhe Kryeministrit, duke propozuar masa konkrete në rast se evidentohen shkelje ligjore nga regjistruarit. Në çdo rast, Kryeregjistruari konfirmon ose rrëzon në mënyrë të motivuar argumentimin ligjor të bërë nga regjistruari.

9. Kërkuesi, që paraqet kërkesë për kryerjen e një shërbimi nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pajiset me një numër identifikimi të kërkesës dhe kodin e sigurisë, me anë të të cilëve mund të verifikojë gjendjen e trajtimit të kërkesës së tij.

10. Verifikimet e kryera nga kërkuesit lënë gjurmë në sistem dhe nuk mund të ndryshohen nga asnjë punonjës i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

11. Në rast ankese kundrejt Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, kërkuesit, përveç të dhënave të përmendura në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të përmendin edhe numrin e identifikimit personal me të cilin janë pajisur nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.



12. Kthimi i përgjigjes dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesi kryhet nëpërmjet shërbimit postar, duke verifikuar dorëzimin pranë adresës së kërkuesit.

13. Kthimi i përgjigjes detyrimisht duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e kërkuesit, numrin e kërkesës, datën e regjistrimit të saj dhe datën e kthimit të përgjigjes së kërkesës. Kthimi i përgjigjes, duke përjashtuar dokumentet autentike që e shoqërojnë, kryhet në mënyrë elektronike, nëpërmjet postës elektronike dhe shpallet në mënyrë elektronike.

14. Çdo regjistruar është i detyruar të raportojë me shkrim, jo më pak se dy herë në muaj të Kryeregjistruarit, të dhënat që lidhen me trajtimin e kërkesave dhe dinamikën e përfundimit të tyre, indeksin e trajtimit të ankesave, si dhe zbatimin e urdhrave të organit epror.

15. Kryeregjistruari vë në dijeni, me shkrim, në fund të çdo muaji, Ministrin e Drejtësisë për numrin e kërkesave të paraqitura, dinamikën e përfundimit të tyre, indeksin dhe proceset e ankimit administrativ pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe për zbatimin e urdhrave e udhëzimeve të lëshuara nga ky organ dhe nga Departamenti i Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit, në Kryeministri.

16. Çdo tarifë për shërbimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, paguhet në llogarinë bankare të zyrës së regjistrimit.

17. Kryeregjistruari nxjerr urdhra dhe udhëzime të hollësishme për trajtimin e procesit të përpunimit të dokumentacionit, format dhe procedurat për zbatimin e këtij vendimi.

18. Vendimi nr. 24, datë 19.1.2007 i Këshillit të Ministrave “Për procedurën e lëshimit të dokumenteve nga disa zyra të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe ndryshimin e tarifave për to”, shfuqizohet.

19. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë dhe Kryeregjistruari i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr. 377, datë 6.6.2012**

**PËR KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJË ORGANI QË REALIZON MBIKËQYRJEN  
ELEKTRONIKE, RREGULLAT PËR PËRZGJEDHJEN DHE TË DREJTAT E  
DETYRIMET E TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 11 të ligjit nr. 10 494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Organi shtetëror që realizon mbikëqyrjen elektronike, në fazën e projektit pilot, është Shërbimi i Provës, pranë Ministrisë së Drejtësisë.

2. Ministria e Drejtësisë, si organ epror i Shërbimit të Provës, ka detyrimet e mëposhtme:

a) t'i sigurojë Shërbimit të Provës mjedise të mjaftueshme për realizimin e mbikëqyrjes elektronike;

b) të sigurojë personelin e nevojshëm për realizimin e mbikëqyrjes elektronike;

c) të marrë të gjitha masat për të siguruar trajnimin e personelit shtetëror të përfshirë në mbikëqyrjen elektronike;

ç) të sigurojë postet e punës për kompjuterët e përdoruesve fundorë (*client computers*) për sistemin e mbikëqyrjes elektronike;

d) të sigurojë shpejtësi të mjaftueshme të aksesit në internet të kompjuterëve fundorë për komunikimin nëpërmjet internetit (*via web*) me sallën operative.

3. Ministria e Drejtësisë, për realizimin e mbikëqyrjes elektronike, kontraktin, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nëpërmjet procedurës së hapur, tender ndërkombëtar, shërbimet e një subjekti që ka eksperiencën e nevojshme në fushën e mbikëqyrjes elektronike.

4. Subjekti i përmendur në pikën 3 të këtij vendimi, duhet të sigurojë:

a) trajnimin e stafit të Ministrisë së Drejtësisë apo Shërbimit të Provës, të përfshirë në mbikëqyrjen elektronike;

b) ofrimin e pajisjeve të nevojshme për realizimin e mbikëqyrjes elektronike;

c) mirëmbajtjen e të gjitha pajisjeve për realizimin e mbikëqyrjes elektronike;

ç) asistencën teknike për realizimin e mbikëqyrjes elektronike.

5. Kushtet që duhet të plotësojë subjekti i përmendur në pikën 3 të këtij vendimi, janë:

a) të ketë një eksperiencë, të paktën, trevjeçare në fushën e mbikëqyrjes elektronike në shtete të tjera;

b) të ketë eksperiencë në sigurimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi që siguron mbikëqyrjen elektronike;

c) të jetë i pajisur me certifikatën e sigurisë së informacionit;

ç) të mos ketë qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

6. Kriteret teknike të pajisjeve elektronike për realizimin e mbikëqyrjes elektronike dhe detyrimet e subjektit, të parashikuara në pikën 3, përcaktohen nga aneksi që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

## ANEKSI 1

Subjekti duhet të ofrojë pajisjet e nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes elektronike, këto pajisje duhet të plotësojnë kriteret teknike të mëposhtme:

### PAJISJA ELEKTRONIKE

1. Pajisja elektronike duhet të përmbushë kriteret e parashikuara në nenin 13 të ligjit nr. 10 494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”.

2. Pajisja elektronike mund të përbëhet nga një pajisje e identifikimit personal (PIP) dhe një njësi mbikëqyrjeje fikse ose e lëvizshme e cila komunikon me sallën operative duke përdorur një linjë telefoni fikse ose një linjë telefonike celulare. Në këtë rast pajisja elektronike, përveç kriterëve të përcaktuara në paragrafin e parë të kësaj pike, duhet të ketë këto karakteristika:

a) Duhet të ketë mundësinë të instalohet në kyçin e këmbës ose, në raste të jashtëzakonshme, në kyçin e dorës të subjektit që është në mbikëqyrje elektronike;

b) Nuk duhet të ketë emër ose logo mbi të;

c) Duhet të ketë mbi të një numër identifikimi (ID) dhe një numër telefoni që të thirret në rast urgjence;

ç) Duhet të punojë në temperatura nga minus 20 deri në 50 gradë celsius;



d) Duhet të përballojë, të detektojë dhe të raportojë çdo tentativë të paautorizuar për ta hequr, dëmtuar, apo tjetërsuar me çfarëdo mënyre tjetër;

dh) Duhet të ketë mundësinë që të komunikojë me njësinë fikse të mbikëqyrjes në një largësi prej 50 metrash;

e) Duhet të përdorë një frekuencë radio të miratuar;

ë) Jetëgjatësia e baterisë duhet të jetë të paktën 12 muaj me një shenjë paralajmëruese kur mbeten më pak se 48 orë nga shkarkimi i saj;

f) Duhet të jetë rezistente ndaj çdo rrezatimi të pajisjeve elektro-shtepiake;

g) Duhet të jetë e papërshkueshme nga uji.

3. Njësia fikse e mbikëqyrjes vendoset brenda mjedisit në të cilin subjektit i lejohe të lëvizë. Ajo duhet të ketë mundësinë të komunikojë me pajisjen e identifikimit personal dhe sallën operative nëpërmjet linjës së telefonit fiks ose nëpërmjet linjës telefonike celulare.

4. Njësia fikse e mbikëqyrjes duhet të ketë këto karakteristika:

a) Duhet të ketë një pamje të tillë që të mos bjerë lehtësisht në sy;

b) Nuk duhet të ketë emër ose logo mbi të;

c) Duhet të ketë mbi të një numër identifikimi (ID) dhe një numër telefoni që të thirret në rast urgjence;

ç) Duhet të ketë një përbërje të fortë që të përballojë, të detektojë dhe të raportojë çdo tentativë të paautorizuar për ta hequr, dëmtuar, apo tjetërsuar me çfarëdo mënyre tjetër;

d) Duhet të ketë mundësinë të punojë me bateri për të paktën 48 orë në rast ndërprerjeje të energjisë;

dh) Duhet të jetë në gjendje të instalohet në një shtëpi të zakonshme pa nevojitur ndonjë modifikim/ndryshim;

e) Duhet të ketë mundësi të detektojë pajisjen e identifikimit personal në një largësi prej 50 metrash;

ë) Çdo njësi fikse mbikëqyrjeje duhet të jetë në gjendje të mbikëqyrë në mënyrë të njëkohshme 10 pajisje të identifikimit personal në zonën e mbikëqyrur;

f) Duhet të jetë në gjendje, me kërkesë të sallës operative ose automatikisht mbas ndonjë ngjarjeje, të dërgojë një raport që përfshin: ndryshimin e llojit të furnizimit me energji; dëmtime të njësive fikse të mbikëqyrjes; mosfunksionimin e pajisjes personale të identifikimit në zonën e mbikëqyrur;

g) Duhet të ketë aftësinë dhe mundësinë për të kontrolluar çdo tentativë për të dëmtuar ose penguar funksionimin e njësive fikse të mbikëqyrjes e cila përfshin: fikje, lëvizje të njësive fikse të mbikëqyrjes, tentativë për të hapur njësinë fikse të mbikëqyrjes apo çdo tentativë të paautorizuar për ta hequr, dëmtuar, apo tjetërsuar me çfarëdo mënyre tjetër;

gj) Duhet të jetë rezistente ndaj çdo rrezatimi që prodhojnë pajisjet shtëpiake;

h) Duhet të jetë e papërshkueshme nga uji.

5. Njësia e lëvizshme e mbikëqyrjes është një pajisje e vogël e cila mundëson marrjen e sinjaleve nga pajisja e identifikimit personal. Ajo duhet të ketë mundësinë e komunikimit me sallën operative nëpërmjet rrjetit telefonik celular.

6. Njësia e lëvizshme e mbikëqyrjes duhet të ketë këto karakteristika:

a) Duhet të ketë një pamje të tillë që të mos bjerë lehtësisht në sy dhe të jetë e lehtë për t'u transportuar/lëvizur;

b) Nuk duhet të ketë emër ose logo mbi të;

c) Duhet të ketë mbi të një numër identifikimi (ID) dhe një numër telefoni që të thirret në rast urgjence;

ç) Duhet të ketë një përbërje të fortë që të përballojë, të detektojë dhe të raportojë çdo tentativë të paautorizuar për ta dëmtuar, apo tjetërsuar me çfarëdo mënyre tjetër;



d) Duhet të jetë në gjendje të detektojë të gjitha pajisjet e identifikimit personal në një rreze prej 200 metrash;

dh) Duhet të jetë në gjendje të sigurojë diferencimin dhe dallimin e të gjitha pajisjeve të identifikimit personal në zonën e mbikëqyrur;

e) Duhet të ketë mundësinë/aftësinë që të punojë me bateri për të paktën 18 orë.

ë) Duhet të jetë i papërshkueshëm nga uji;

f) Duhet të jetë në gjendje, me kërkesë të sallës operative ose automatikisht mbas ndonjë ngjarjeje, të dërgojë një raport që përfshin: dëmtime të njësisë së lëvizshme të mbikëqyrjes; mosfunksionimin e pajisjes së identifikimit personal në zonën e mbikëqyrur;

g) Duhet të ketë aftësinë dhe mundësinë për të kontrolluar çdo tentativë për të dëmtuar ose penguar funksionimin e njësisë së lëvizshme të mbikëqyrjes e cila përfshin: fikje, tentativë për të hapur njësinë e lëvizshme të mbikëqyrjes apo çdo tentativë të paautorizuar për ta hequr, dëmtuar, apo tjetërsuar me çfarëdo mënyre tjetër.

7. Pajisja elektronike mund të jetë gjithashtu një njësi e mbikëqyrjes GPS, e cila duhet të jetë e pajisur me module komunikimi RF, GPS, GPRS. Në këtë rast pajisja elektronike, përveç kriterëve të përcaktuara në paragrafin e parë të kësaj pike, duhet të ketë këto karakteristika:

a) Duhet të ketë mundësinë të instalohet në kyçin e këmbës ose, në raste të jashtëzakonshme, në kyçin e dorës të subjektit që është në mbikëqyrje elektronike;

b) Nuk duhet të ketë emër ose logo mbi të;

c) Duhet të ketë mbi të një numër identifikimi (ID) dhe një numër telefoni që të thirret në rast urgjence;

ç) Duhet të përballojë, të detektojë dhe të raportojë çdo tentativë të paautorizuar për ta hequr, dëmtuar, apo tjetërsuar me çfarëdo mënyre tjetër;

d) Duhet të ketë mundësi të punojë me bateri për të paktën 24 orë;

dh) Duhet të ketë mundësinë të tregojë vendndodhjen e subjektit duke përdorur sinjal GPS;

e) Duhet të ketë mundësinë e komunikimit interaktiv me subjektin nëpërmjet dridhjeve dhe alarmeve;

ë) Duhet të jetë rezistente ndaj çdo rrezatimi që prodhojnë pajisjet shtëpiake;

f) Duhet të jetë e papërshkueshme nga uji.

#### SALLA OPERATIVE

1. Salla operative duhet të përmbushë kriteret e parashikuara në nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 10 494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”.

2. Salla operative përbëhet prej pajisjeve fizike (hardware), programeve kompjuterike (software) dhe pajisjeve që janë receptorë dhe analizues të sinjaleve që dërgohen nga pajisjet e identifikimit personal dhe njësitë e mbikëqyrjes. Programi kompjuterik (software) menaxhon mbikëqyrjen e përgjithshme të subjekteve. Vendndodhja dhe çdo informacion tjetër, si mesazhet dhe alarmet në tërësinë e sistemit, përfshirë këtu edhe alarmet që shkaktohen kur personi i mbikëqyrur nuk është brenda zonës së kontrollit në kohën e paracaktuar, ose po vepron në mënyrë të paautorizuar mbi pajisjet, pasqyrohen në programin kompjuterik (software) në mënyrë të vazhdueshme.

3. Salla operative, përveç kriterëve të përcaktuara në pikën e parë të këtij neni, duhet të ketë këto karakteristika:

a) Sistemi kryesor i kontrollit (serveri) duhet të jetë i pajisur me të gjitha pajisjet e komunikimit të nevojshme për marrjen (receptimin) dhe dërgimin e të dhënave;

b) Një sistem rezervë identik duhet të jetë i instaluar, me qëllim që të marrë menjëherë kontrollin e të gjitha funksioneve të mbikëqyrjes në rast të defekteve apo rënies së sistemit kryesor;



- c) Sistemet duhet të furnizohen me energji të pandërprerë. Në rast ndërprerjeje, duhet të garantojë furnizim të pandërprerë me energji për një periudhë kohore prej të paktën 24 orësh;
- ç) Duhet të jetë e pajisur me një sistem alarmi i cili i informon personelit defektet ose rënien e serverit kryesor;
- d) Sistemi i monitorimit duhet të jetë unik për secilën nga pajisjet që do të përdoren;
- dh) Gjuha e përdorimit duhet të jetë gjuha shqipe;
- e) Sistemi duhet të sigurojë kriptimin e informacionit, në mënyrë që monitorimi të mund të bëhet edhe nga jashtë mjediseve të sallës operative;
- ë) Pasqyrimi dhe verifikimi i informacionit duhet të bazohet në rrjetin ndërkombëtar *world wide web* nëpërmjet një shfletuesi të zakonshëm (web browser);
- f) Duhet të ketë mundësinë për të kontrolluar njëkohësisht 300 persona;
- g) Duhet të ketë aftësinë për të iniciuar procedurat standarde të veprimit për çdo rast që mund të paraqitet, duke përfshirë një rreze të gjerë alarmesh pamore dhe zanore në varësi të llojit të shkeljes dhe rrezikut që paraqet personi nën mbikëqyrje elektronike;
- gj) Duhet të ketë të gjitha programet kompjuterike të nevojshme për një operim normal të sistemit, gjithashtu duhet të ketë aftësinë që të mbajë kopje rezervë të të gjithë sistemit;
- h) Duhet të regjistrojë për një periudhë kohore të paktën 6-mujore të gjitha të dhënat e mbledhura, si dhe të gjitha alarmet dhe ngjarjet që kanë ndodhur në çdo pikë të sistemit;
- i) Duhet të ketë aftësinë që të sinkronizojë një orë të vetme në të gjithë sistemin;
- j) Duhet të ketë aftësinë të ruajë dhe të shfaqë informacionet personale për secilin nga personat nën mbikëqyrje;
- k) Duhet të ketë mundësi të përcaktohet dhe programohet koha që nevojitet përpara se një alarm të ndizet në rast të humbjes së komunikimit ndërmjet sallës dhe pajisjeve.

#### DETYRIMET E SUBJEKTIT

1. Subjekti që ofron pajisjet elektronike për realizimin e mbikëqyrjes elektronike duhet:
  - a) Të verë në dispozicion në sasi të mjaftueshme pajisjet për mbikëqyrjen elektronike të subjekteve, duke përfshirë dhe një sasi rezervë të tyre;
  - b) Të instalojë një sallë operative;
  - d) T'i raportojë në mënyrë të përmuajshme Ministrinë të Drejtësisë në lidhje me performancën e sistemit;
  - e) Të bashkëpunojë plotësisht me Shërbimin e Provës;
  - ë) Të mos degradojë cilësinë e shërbimit, pavarësisht përdorimit të teknologjive të reja;
  - f) Të kryejë shërbimin e mirëmbajtjes dhe të asistencës teknike 24 orë në ditë, 7 ditë në javë;
  - g) Të instalojë sistemin e mbikëqyrjes, i cili duhet të vendoset në territorin e Republikës së Shqipërisë;
  - gj) Të furnizojë, instalojë dhe konfigurojë pajisjet që përdor Ministria e Drejtësisë apo organet e tjera shtetërore të përfshira në mbikëqyrjen elektronike;
  - h) Të garantojë sigurinë e komunikimit të të dhënave gjatë komunikimit të Sallës Operative me kompjuterët fundorë të përdoruesve (client computers), përfshirë këtu edhe programe kriptimi;
  - i) Të sigurojë të gjitha pajisjet e nevojshme të komunikimit për të lidhur pajisjet elektronike me sallën operative (karta SIM dhe pajisje të tjera);
  - k) Të trajnojë personat e caktuar nga Ministria e Drejtësisë për përdorimin e sistemit të mbikëqyrjes.

**VENDIM**  
**Nr. 378, datë 6.6.2012**

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË, PËR  
LEHTËSIMIN E PASOJAVE TË SHKAKTUARA NGA TËRMETI NË VERI TË ITALISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Financave, t’i shtohet kundërvlefata e fondit prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) eurosh, për t’iu dhënë si ndihmë financiare qeverisë së Republikës së Italisë për lehtësimin e pasojave të shkaktuara nga tërmeti në veri të Italisë.
  2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
  3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr. 379, datë 6.6.2012**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË  
E BRENDSHME, PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJEVE TË VIKTIMAVE  
DHE TË MBIJETUARVE TË AKSIDENTIT RRUGOR, TË DATËS 21.5.2012, NË AKSIN  
VLORË-SARANDË, NË VENDIN E QUAJTUR VISHË, TË HIMARËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në programin buxhetor “Emergjencat civile”, t’i shtohet fondi i përgjithshëm prej 25 118 000 (njëzet e pesë milionë e njëqind e tetëmbëdhjetë mijë) lekësh, si ndihmë financiare për familjet e viktimave dhe të mbijetuarve të aksidentit rrugor, të datës 21.5.2012, në aksin Vlorë-Sarandë, në vendin e quajtur Vishë, të Himarës.
2. Fondi i dhënë sipas pikës 1 të këtij vendimi, të jetë i ndarë, si më poshtë vijon:
  - a) familjeve të viktimave t’u jepet shuma 1 000 000 (një milion) lekë, për çdo viktimë;
  - b) Për shpenzimet e varrimit të ceremonisë mortore dhe shpenzime të tjera, gjithsej, të jepet shuma 4 618 000 (katër milionë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë) lekë;
  - c) Çdo të mbijetuar t’i jepet shuma 300 000 (treqind mijë) lekë, për rehabilitimin shëndetësor.



3. Fondi i dhënë, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të transferohet pranë prefektëve të qarqeve, të cilët, në bazë të procedurave ligjore dhe të dokumenteve, përfshirë dokumentin e identifikimit dhe dokumentet mjekësore, t'u shpërndajnë përfaqësuesve të familjeve të viktimave dhe të mbijetuarve shumat e përcaktuara në pikën 2 të vendimit, sipas listës me emrat e viktimave dhe listës me emrat e të mbijetuarve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

5. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm dhe prefektët e qarqeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Lista me emrat e viktimave të aksidentit rrugor, në aksin Vlorë-Sarandë, më datë 21.5.2012:

1. Denisa Guzi nga Gramshi
2. Ermira Mana nga Elbasani
3. Aurora Molla nga Pogradeci
4. Lindita Kabashi nga Elbasani
5. Joana Debinja nga Lushnja
6. Elsa Daka nga Elbasani
7. Juliana Tola nga Elbasani
8. Armand Halilaga nga Kavaja
9. Pëllumb Çela, drejtuesi i mjetit, nga Elbasani
10. Fabiola Shehi nga Bërçkulla Tiranë
11. Eriola Xhoi nga Elbasani
12. Eranda Baloshi nga Elbasani
13. Dorina Stafa nga Kruja

Lista me emrat e të mbijetuarve:

1. Adisa Besnik Çela
2. Adjola Bektash Musaku
3. Alma Latif Deda
4. Anisa Xhemali Hysa
5. Antoneta Kadri Taçe
6. Besiana Bujar Xheneti
7. Besiana Osman Dani
8. Anisa Lefter Çobaj
9. Blerina Astrit Çeremi
10. Dorianë Daut Kumrija
11. Elidona Dod Gjinaj
12. Elsa Hodo Shtylla
13. Eranda Naum Bardho
14. Ergita Llambro Opingari
15. Eriselda Kadri Gubere
16. Florie Selman Peci
17. Griselda Mehmet Zeneli
18. Ifsjana Xhevair Karriqi

19. Juliana Vladimir Kuqi
20. Kaltra Fatos Pollozhani
21. Liri Mahmud Hasa
22. Mirsie Xhevat Biba
23. Shegushe Ismail Haka
24. Ticiana Shyqyri Hysa
25. Enkela Daja

**KËRKESË**  
**Nr. 2758, datë 13.6.2012**  
**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajshme, pronë private, që preken nga masterplani miratuar me vendimin nr. 546, datë 28.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e masterplanit për zhvillimin e Portit të Durrësit”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Portual Durrës. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarin, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronari që ka emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pronari, për të cilin, në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, do të kompensohet për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Portual Durrës (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë, pronë private, për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 114 010 387 (njëqind e katërbëdhjetë milionë e dhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë.

**MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE  
DHE TRANSPORTIT  
Sokol Oldashi**

**AUTORITETI PORTUAL DURRËS**  
**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË “HYRJES**  
**NR. 4 TË RE, SEGMENTIT RRUGOR NGA HYRJA NR. 4 TEK TERMINALI I RI I**  
**TRAGETEVE DHE REHABILITIMIN E SHESHIT PRANË HYRJES NR. 4 NË PORTIN E**  
**DURRËSIT”**

Nr.	Pronari			ZK	Nr. i pas.	Truall m <sup>2</sup>			Objekte vlera, lekë	Vlera totale, lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			m <sup>2</sup>	Çmimi	Vlera në lekë			
1	“Albtelekom” sh.a.			8514	6/111	3289	30000	98,670,000	15,340,387	114,010,387	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	<b>Totali</b>					<b>3289</b>		<b>98,670,000</b>	<b>15340387</b>	<b>114,010,387</b>	



## VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 1317, datë 10.5.2012, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Elvis Ahmetlli, i biri i Tekiut dhe i Pranverës, i datëlindjes 21.3.1974.

## KËRKESË

Shtetasja Themie Bobo, e bija e Janit, e datëlindjes 8.9.1925, lindur e banuese në Krutje të Sipërme, Lushnjë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj shtetasit Prendi Bobo.

KËRKUESE  
**Themie Bobo**

## KËRKESË

Shtetasi Nevruz Alla, i biri i Qerimit dhe i Bajames, i datëlindjes 7.9.1943, lindur e banues në Kallm i Madh, Fier kërkon pranë Gjykatës së Rrethit gjyqësor Fier shpalljen të zhdukur të vajzës së tij, shtetases Brunilda Alla.

KËRKUESI  
**Nevruz Alla**

## KËRKESË

Shtetasja Donika Karaj, e bija e Mitrit dhe e Kalijes, e datëlindjes 29.9.1945, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat shpalljen të vdekur të shtetasit Josif Karaj.

KËRKUESJA  
**Donika Karaj**



**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 20.6.2012  
Doli nga shtypi më 21.6.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 26 lekë